ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-22-5200-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
NUI	**811498957**
Adresa	**Taslixhe II**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**+38344158638**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Lulzim Katanolli**
Adresa elektronike	**drkatanolli@yahoo.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**28.02.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore.

Autortiteti Kontraktues permes komisionit te vleresimit, ka refuzuar Kerkesat Per Rishqyrtim duke aplikuar standard te dyfishte te vleresimit te dokumentacionit kunderligjshem.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Me datën 30.01.2024 AK, përmes njoftimit ka shpërblyer OE Grupin e Operatorëve S.V Veterina & N.N.P Wenda, me kontratën objekt tenderi. Publikimi eshte bere me vone.

Me dt. 16.02.2024, OE Ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim, e cila kërkesë është Refuzuar nga AK përmes vendimit të dt.23.02.2024.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me dt. 16.02.2024, OE Ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim, e cila kërkesë është Refuzuar nga AK përmes vendimit të dt.23.02.2024. kopja do bashkangjit ne dokumentet a ankeses.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se janë shkelur dispozitat ligjore si në vijim:

Neni 1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 6 Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 10 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në pajtim me të gjitha dispozitat ligjore për konkurrim në tender publik, kompania DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K., ka aplikuar dhe është shpallur fitues në tenderin me titull: "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në Objektet Policore- vazhdim afati 6" me nr. prokurimi: 214-22-5200-2-1-1: Me numër brendshëm 214/22/078/211.

Me vendimin nr.2023/0605 të dt.01.12.2023, OSHP, tenderi me numër prokurimi 214-22-5200-2-1-1, anulohet, ndërsa aktiviteti është kthyer në ri-vlerësim.

Me datën 30.01.2024 AK, përmes njoftimit ka shpërblyer OE Grupin e Operatorëve S.V Veterina & N.N.P Wenda, me kontratën objekt tenderi.

Me dt. 16.02.2024, OE Ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim, e cila kërkesë është Refuzuar nga AK, përmes vendimit të dt.23.02.2024.

Andaj duke pasur parasysh gjithë rrjedhën e procedurës, si dhe vendimin e refuzuar nga ana Autoritetit Kontraktues – Policia e Kosovës, pala ankuese konsideron se i njëjti vendim është marrë me shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale si dhe është i pa arsyetuar në prova dhe fakte relevante për çështjen, ka arsyetime kontradiktore edhe me vetë vendimin e marrë e kjo bazuar në fakte të përmendura nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Vendimi i dt. 23.02.2024 nga AK Policia e Kosovës – Departamenti i Prokurorimit përmes të cilit refuzohen kërkesat për rishqyrtim dhe mbështetet njoftimi për dhënien e kontratës nga AK Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit nr: prok*:* 214-22-5200-2-1-1, nr. i brendshem 214/22/078/211, sa i përket tenderit për "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në Objektet Policore ri-vlerësim", është proces jo i rregullt për shkak se është marrë në shkelje të dispozitave ligjore si më poshtë:

Neni 1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 6 Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 10 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Në vazhdim do të paraqiten pretendimet e përgjithshme të procesit të tenderimit që konsiderojmë se nuk janë respektuar nga AK, të cilat pretendime disa prej tyre do të përseritën edhe në ankesë për shkak se AK, ka devijuar në arsyetimin dhe vlerësimin në pretendimet e ngritura, e disa pretendime nuk i ka trajtuar fare, e kjo tregon qartë favorizimin e OE Fitues, dhe diskriminimin në dëm të OE Ankues, e këto pretendime ankimore do ti listojmë si në vijim:

AK ka shkelur nenin 1 par. 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Prokurim Publik, ashtu që neni 3 par.1 i Ligjit për Prokurimin Publik në të cilin përcaktohet se "*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla*", e që AK, në mënyrë direkte i shkelë paragarafët e nenit 1 të LPP-së, me rastin që ka shpallur fitues të tenderit Grupin e Operatorëve Ekonomik S.V. Veterina dhe N.N.P. Wenda, Vushtrri.

Kurse Autoriteti Kontraktues në faqen 2 të vendimit të dt.23.02.2024, thekson se kinse AK në mënyrë të drejtë dhe efikase ka shfrytëzuar fondet publike, ashtu që kinse se nuk ka diskriminuar apo nuk ka favorizuar asnjë OE.

Kjo nuk qëndron fare pasi që në bazë të dokumentacioneve të dorëzuara nga S.V Veterina, lehtë është dashur komisioni i vlerësimit të AK, të vije në përfundimin se OE Fitues realisht është dashur të shpallet e papërgjegjshme, e aq më pak të shpallet fituese, e këto pretendime do të elaborohen edhe në vijim të kësaj ankese sipas radhës.

Nuk qëndron konstatimi i AK, në faqen 3 të vendimit se të gjithë operatorët janë trajtuar në mënyrë të barabartë, për shkak se në vendimin e marr refuzues dështmohet e kundërta sepse nuk është bërë vlerësimi në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët.

Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par.1 të LPP-së, dhe par.2 të nenit 7 të LPP-së, kjo për faktin se duke i analizuar Grupin e Operatorëve Ekonomik S.V Veterina dhe N.N.P. Wenda, Vushtrri, që janë shpallur apo shpërblyer me kontratë, nga shikimi dhe analizmi i çertifikatës së biznesit fillimisht e Operatorit Ekonomik S.V Veterina,Vushtrri me Numër Unik Identifikues 810692857, i cili si veprimtari apo aktivitet nën kodin 7500 ka Aktivitetet e Veterinarisë, kurse nën kodin 8121 ka pastrimin e përgjithshëm të ndërtesave, kurse Operatorit Ekonomik N.N.P. Wenda Vushtrri me Numër Unik Identifikues 810685638, i cili si veprimtari apo aktivitet nën kodin 4120 ka ndërtimin e objekteve banesore, nën kodin 4321 ka instalimet elektrike, nën kodin 4329 ka instalimet tjera ndërtimore, nën kodin 4639 ka tregtinë me shumicë të produkteve ushqimore, nën kodin 8121 ka pastrimin e përgjithshëm të ndërtesave etj, pra asnjë aktivitet i regjistruar i OE N.N.P. Wenda Vushtrri, nuk ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve të DDD, andaj AK nuk është dashur të lejoj që ky grup i operatorëve ekonomike të

shpërblehet me kontratë, sepse bashkimin në konzorcioum duhet të jetë apo përbëhet nga aktiviteti i njëjtë sikurse që është hapur tenderi, e në rastin konkret të këtij operatori fare nuk ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve të DDD. **Pra të dy OE fitues nuk e kanë aktivitetin nën kodin 81.29 që ka të bëjmë më "Aktivitetin Dezinfektimit dhe Asgjësimit".**

Kurse AK në vendimin e vet thekson se nuk është kërkuar që të dëshmohen me kode veprimtaritë e kompanive, por që kjo është kruciale pra e domosdoshme për aktivitetin e prokurimit, për shkak se nuk është e ligjshme që një firmë të ofrojë shërbime e për të cilat shërbime/aktivitete nuk është e regjistruar në ARBK.

AK ka shkelur edhe nenin 9 par.1 të LPP-së, për arsye në dosjen e tenderit tek pika pika 7.1 dhe 7.2 Përshtatshmëria profesionale: *Kërkesa 5. Leja e Importit për produkte biocide insekticide të lëshuar nga autoritet relevante, që sa i përket lejes së importit të produketeve biocide e lëshuar nga MBPZHR të dt.22.04.2022 mungojnë preparatet biocide në ofertën e tenderit nga OE fitues, përkatësisht kjo leje nr.226-2/22 është faqja e parë dhe e tretë, pra faqja e* ***dytë "mungon".*** **Kurse prezantimi i faqes së parë dhe të tretë të lejes së importit pa listë të preparateve që do të importohen (*faqja e dytë "mungon"*), nga OE Fituese mund të cilësohet si tentim mashtrimi ndaj AK dhe ofertuese të tjerë, që do të thotë se OE Fitues nuk ka poseduar leje të mirëfilltë të importit, kurse arsyetimi i AK që ka poseduar OE leje të importit por ajo ka skduar e bënë pjesëmarrës në mashtrim edhe AK, dhe favorizues të konzorciuimit Grupin e Operatorëve Ekonomik S.V Veterina dhe N.N.P. Wenda, Vushtrri, plotësisht të pa përgjegjshëm që nga fillimi i ofertimit.**

Po ashtu AK ka devijuar me përgjigje sepse pretendimi nga OE tani ankues nuk ka qenë i ngritur për vlefshmërinë e lejes së importit por për vendimin *nr.226-2/22 të dt.22.04.2022, për lejen e importit të produketeve biocide e lëshuar nga MBPZHR, të cilit vendim i mungon faqja e dytë, dhe si duket kjo nuk është rastësi, andaj është e domosdoshme që ky operator me këto manipulime të eliminohet për shkak se nuk mjafton vetëm të ketë leje nga organi kompetent por duhet të dihet përmbajtja e lejes dhe të gjitha produktet që ka leje, a është leje për import, a është leje për tregti apo është leje për përdorim të produkteve biocide, e që të gjitha këto kanë dallime esenciale, e komisioni i vlerësimit në AK, është dashur ti ketë parasysh këto.*

AK ka shkelur edhe nenin 9 par.1 të LPP-së, tek kapaciteti profesional sa i përket Kërkesa 6. Të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 2015 për cilësinë e shërbimeve te DDD nga një kompani e licencuar. E kjo ISO 9001 2015, e dorëzuar nga Safet Osmani B.I – S.V Veterina është e pavlefshme nga data 10.10.2023, ku është e cekur me të kuqe (withdrawn – e tërhequr, me dt.10.10.2023), nga kompania për çertifikimin e ***ISO-ve G-CERTI, si dhe nuk posedon ISO 9001 2015 për kontrollin e gjarpinjëve. Shih hulumtimin e kompanisë me datë të lëshimit 10.08.2022, me periudhë të validitetit prej 10.08.2022 deri me 09.08.2023, kështu që nga kjo konstatohet se i njëjti OE ka ofruar dhe me këtë ka fitur tender me ISO 9001 2015, TË SKADUAR, pasi që e njëjta është tërhqur nga***

kompania për çertifikimin e ***ISO-ve G-CERTI me dt.10.10.2023. Po ashtu në përmbajtje të kësaj çertifikate ISO shënohet "Tregtia e produkteve veterinare Shërbimi DDD, Shërbime dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimit për të gjitha llojet e ndërtesave, parqeve, pyjeve etj. (Provë e bashkëngjitur). Këtu mungon shërbimi i dezinsektimin, e në dojsen e tenderit kërkohet që ISO 9001 2015, të përfshihet edhe shërbimi i dezinsektimin.***

AK në vendimin e saj në faqen 4 jep arysetimin në pretendimet e ngritura lidhur me vlefshmërinë e certifikatës të ISO të lartëcekur me të cilën thekson ***"se në kohën kur oferta është dorëzuar nga grupi i OE ISO 9001-2015 ka qenë valide***", por që OE ankuese konsideron që ky është një arsyetim i kundërligjshëm për arsye se i tërë procesi i tenderimit është kthyer në rivlerësim nga OSHP pikërisht për skadimin e lejeve të importit sepse të njëjtat kanë qenë valide në kohën kur është dorëzuar oferta por për shkak të zgjatjes së procedurës së tenderimit, këtyre lejeve u ka kaluar afati dhe e njëjta gjë vlen edhe për certifikatat ISO. Andaj, Komisioni Vlerësues i AK në këtë rast po e cenon në mënyrë të kundërligjshme parimin e sigurisë juridike duke përdorur standard të dyfishtë të vlerësimit të tenderëve sepse në provat e bashkëngjitura Kërkesës për Rishqyrtim konstatohet pa mëdyshje se certifikata e OE fitues me datë të lëshimit 10.08.2022 ka qenë valide prej periudhës 10.08.2022 deri më datën 09.08.2023, kurse ka skaduar dhe është tërhequr nga kompania për certifikimin e ISO G-Certi me datën 10.10.2023. AK në bazë të kësaj është dashur që në mënyrë automatike grupin e operatorëve fitues të i shpallë të papërgjegjshëm për shkak se të njëjtit kanë paraqitur certifikatë të ISO që ju ka skaduar validiteti (***Rasti i njëjtë sa për ilustrim është tek vlefshmëria e skaduar e policës së sigurimit por që kjo vlefshmëri është vazhduar, e nuk është e njëjta gjë me certifikatën ISO 9001-2015***).

Kjo çertifikatë **ISO 9001-2015, është çertifikatë për menaxhimin e cilësisë së shërbimeve për të cilën behet auditimi vjetor** dhe duke qenë se kompania fituese nuk e ka bërë auditimin vjetor, atehere i bije se G-Certi si kompani çertifikuese e terheq çertifikatë ISO 9001-2015, për shkak të mos përmbajtjes të obligimeve të kompanisë, gjithmonë duke marrë parasysh se në dosjen e tenderit është kërkuar çertifikata ISO 9001-2015. **Këtë e ka kërkuar edhe Kërkesa 6. E dosjes së tenderit që të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 2015 për cilësinë e shërbimeve te DDD nga një kompani e licencuar, valide (e noterizuar).**

Nga AK është kërkuar Lista e stafit profesional për shërbime të DDD e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Minimum Tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lëminë e DDD-së. Me Dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë . Me Kontratë pune ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin për angazhim për këtë projekt.

Në këtë rast OE referencat të cilat ua ka lëshuar punëtorëve të vet i ka pasur të pa nënshkruara dhe të pa vulosura.

Në listën e stafit nuk është emri i një punëtori F. Rrahmani por vetëm kontrata e lidhur në mes tij dhe punëdhënsit, kurse përvoja nuk është e prezentuar me referencë. Gjithashtu kontratat e lidhura në mes punëdhënsit dhe punëtorve të cilët janë në listë nuk janë në rregull (nenet e tyre bien ndesh me njëra tjetrën). Kontrata e V. Sadiku tek Neni 2 ceket se k?o kontratë nuk mund të jetë më e gjatë se 120 ditë kalendarike brenda një viti kalendarik, kurse tek Neni 6 ceket se punëmarrsi do të angazhohet nga dt. 01.01.2018 deri në kohë të pa caktuar. E njëjta kontratë vlenë edhe për punëmarrësin tjetër A. Osmani ku ndryshon vetëm data e angazhimit 01.04.2019. Tek kontrata tjetër B. Maloku Neni 2 thotë se kjo kontratë nuk mund të jetë më e gjatë se 2 vite kurse tek Neni 6 ceket se punëmarrsi do të angazhohet për 36 muaj për projektin në fjalë. E njëjta kontratë është edhe e punëmarrësit A. Vllahija. Kurse tek kontrata e punëmarrsit V. Hyseni përveç Neni 2 ku thotë se kjo kontratë nuk mund të jetë më e gjatë se dy vite, kurse tek Neni 6 thuhet se punëmarrësi do të angazhohet nga 22.03.2021 deri 22.03.2022 me mundësi vazhdimi deri në përfundim të projektit në fjalë (kurse projekti është publikuar 10.06.2022).

Është me rëndësi të potencohet se OE fitues pa kërkesë të AK, për plotësimin e dokumentacioneve shtesë, ka bërë dorëzimin e dokumentacioneve të lartë përmendura, pasi që nga AK me datën 03.01.2024 është kërkuar për këta OE ti dorëzojnë vetëm dy dëshmi dhe ajo Kopja e licencës valide e lëshuar nga MBPZHR si dhe Leja e importit për biocide dhe insekticide e lëshuar nga autoritetet relevante kopje.

Por pavarësisht kësaj OE fitues me vetë inciativë dhe **kundërligjshëm duke i bashkëngjitur jashtë afateve të dosjes së tenderit referencat e nënshkruara dhe të vulosura, mirëpo kjo nuk është e lejuar për arsye se dosja e tenderit dhe ofertat është dashur të vlerësohen me dokumentacione ekzistuese me përjashtim të lejeve që kanë afate kohore dhe për të njëjtat kanë kërkuar plotësime, e jo dokumentacione tjera jashtë afateve kohore, po ashtu leja e dorëzuar me 06.01.2024, për import të produkteve biocide të dt.02.10.2023, është leje vetëm për import dhe dalje në treg të produkteve biocide dhe nuk është leje për përdorim nga i njëjti OE, gjithashtu kjo leje e ofruar nga OE Fitues nuk korespondon me preparatet e paraqitura në lsitën e preparateve të ofruara nga OE Fitues për shërbimet e Dezinsektimit dhe Deratizimit, Leja e importit gjithashtu nuk dëshmon se ka preparat për Dezinfektim, e cila edhe kërkohet në specifikacionin e detyrueshëm teknik, Shih vendimin nr.5294-2/23**.

Sa i përket bashkëngjitjes së dokumentacioneve shtesë pa kërkesën paraprake të AK nga OE fitues dhe arsyetimit të AK në vendimin e saj se kinse këto plotësime janë bërë konform vendimit të OSHP nuk qëndron për arsye se vendimi i OSHP në të gjitë pjesën e tij arsyetuese ka ngritur pretendimet sa i përket lejes së produkteve biocide dhe vlefshmërisë së tyre dhe në asnjë rast nuk ka udhëzuar që OE fitues tani të i bashkëngjes kontratat dhe referencat e vulosura dhe të nënshkruara.

Po ashtu në listën e punëtoreve numrin rendor 6, është punëtori Mithat Eminoviç që posedon kontrate me OE fitues si specialist i epidemiologjisë por nuk posedon leje të punës që lëshohet nga Oda e Mjekëve të Kosovës, po ashtu edhe diploma e specializimit të tij e lëshuar në Serbi nuk është e Nostrifikuar në Republikën e Kosovës dhe është e kundërligjshme të angazhohet për kryerjen e shërbimeve të DDD, pa leje adekuate në Republikën e Kosovës.

AK nuk e ka trajtuar dhe analizuar me profesionalizem rastin ku sipas dosjes së tenderit pika 8.1 dhe 8.2, sa i përketë kontratave/qarkullimit në vlerë prej 200.000,00 euro, në tri vitet e fundit, e kjo fillimisht e operatorit ekonomik S.V Veterina Vushtrri, nga lista e kontratave për vitin 2020, 2021 dhe 2022, nga ky operatorët janë përshkruar 10 kontrata gjatë këtyre tri viteteve në shumën totale prej 52,873.25 euro, dhe kryesisht për shërbime të DDD, por kur analizohet lista e kontratave të operatorit ekonomike N.N.P. Wenda Vushtrri, e cila titullohet si "Deklaratë mbi realizimin e kontratave në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit", nga kjo listë prej numrave 1, 2, 3 dhe 4, janë vlera të kontratave që nuk kanë të bëjnë fare me shërbime të DDD, kurse vetëm numri 5 dhe 6 janë shërbime DDD, por që nuk kalojnë shumën prej 12.000,00 euro, e si kusht nuk është dashur të konsiderohet si kusht i plotësuar nga AK.

AK nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë këtë pretendim dhe përgjigja e të njëjtit është jo profesionale për arsye se qarkullimet në 3 vitet e fundit të OE që duhet të jenë jo më pak se 200.000,00 euro është dashur që të jenë nga aktiviteti i njëjtë apo i ngjashëm i prokurimit dhe jo aktivitete tërësisht të ndryshme sepse aktivitetet e DDD duhet të kryehen nga firma të licencuara dhe profesionale dhe të regjistruara për këtë aktivitet.

Po ashtu sa i përket pikës 9.1 dhe 9.2 tek kapacaiteti teknik dhe profesional Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara në vlerë prej 100,000.00 € deri në publikimin e njoftimit për kontratë. E nga provat e dorëzuara nga vetë OE si bartës i konzorciumit S V Veterina ka vetëm 52,873.25 euro, e që i bije se nuk ka 60 % të vlerës së kontratave që duhet të këtë si bartës i konzorciumit e që bije që kjo është në kundërshtim me LPP, pasi që është fakt i ditur botërisht se bartësi kryesor i konzorciumit gjithmonë duhet të pjesën me të madhe të përqindjes së pjesëmarrjes, e kjo vetëm për shërbime të DDD, e jo shërbime tjera që nuk janë as të ngashme por që kanë të bëjmë me aktivitete të tjera, e kjo sidomos vlen për OE e dytë N.N.P. Wenda, që nuk ka asnjë shërbim të DDD si kontratë.

Komisioni i Vlerësimit në AK pretendimin e lartëcekur nuk e ka arsyetuar fare dhe nuk është e logjikshme që bartës i konsorciumit të jetë OE i cili në tri vitet e fundit nuk ka kontrata për aktivitetin e DDD mbi 12.000,00 euro. Kjo për faktin se kontratat e tjera të bashkëngjitura fare nuk kanë të bëjnë me aktivitetin e DDD-së.

Po ashtu sa i përketë pikës 9.1 dhe 9.2 tek kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa 3. OE duhet të dorëzoj metodologjinë e punës dhe preparatet e parapara për përdorim, OE fitues ka bërë dorëzimin e metodologjisë së punës fillimisht është e përpiluar dhe nënshkuar e vulosur vetëm prej OE S.V Veterina Vushtrri, e jo edhe nga OE N.N.P. Wenda, e për më tepër në këtë metodologji nuk ka cekur asnjë preparat për shërbime të DDD. **E kjo është kërkesë specifike në Dosjen e tenderit që OE duhet të dorëzoj metodologjinë e punës dhe preparatet e parapara për përdorim.**

AK nuk e ka trajtuar edhe këtë pretendim me profesionalizëm pasi që metodologjia e punës është dashur të nënshkruhet nga të dy palët që janë në konzorcium e jo vetëm njëra e që në të kundërtën i bie që konzorciumi i formuar është vetëm formalisht si i tillë dhe realisht nuk është konzorcium për përfundimin me profesionalizëm dhe përgjegjësi të aktivitetit të prokuorimit. Në kërkesën për rishqyrtim janë dhënë kundërshtimet e kësaj metodologjie të punës në mënyrë të detajuar se preparatet që janë përmendur në këtë program të dezinfektimit nuk kanë të bëjnë asgjë me dezinfektim, pra nuk mbulohet e gjithë fusha e DDD.

Po ashtu në metodologjinë e punës të ofuar nga OE fitues në prograimin DDD paragrafi 1, **metodologjinë e** ***Programi i dezinfektimit***: ***Programi i dezinfektimit ndërmerret për*** ***asgjësimin*** *dhe parandalimin e infestimit të insekteve zvarritëse dëmshme (buburrecat, milingonat, mizat, grerëzat, furrëtaret etj) që janë bartës të agjentëve të sëmundjeve ngjitëse, dezinsektimi do të kryhet me anë të vendosjes së xhelit special me lëndë aktive (**Imidacloprid, Deltametrine, Bromadiolone**) i cili kryhet 2 herë në vit për një periudhë 6 mujore secila, si dhe me spërkatje me pompë me insekticide të miratuara sipas Direktivës 98/8 të BE-së për produktet biocide për përdorim në shëndet publik. Të gjitha këto preparata që janë përmendur në programin e dezinfektimit (**Imidacloprid, Deltametrine, Bromadiolone**, (**ky produkt pra Bromadiolone nuk përdoret as për dezinsektim e as për dezinfektim**) **nuk kanë të bëjnë asgjë me dezinfektim.***

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje sa i përket pikës 9.1 dhe 9.2 tek kapaciteti teknik dhe profesional *Kërkesa 4. OE duhet ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vulosur nga OE me pajisjet ne vijim Së paku 1 pompë motorike – Gjenerator ULV Së paku 5 pompa motorike dhe pajisje të tjera përcjellëse. Kurse në prezentimin e paisjeve të OE të shpallur fitues* ***nuk posedon ULV – ES Elektrostatike e cila është e kërkuar në specifikimin teknik të detyrueshëm ku thuhet "preparatet duhet të jenë të aplikueshme përmes aparatues ULV – ES Elektrostatike (spërkatjeve në formë të një trajtshme)".*** **Pra nuk qëndron konstatimmi i AK, se kjo paisje nuk është kërkuar në dosjen e tenderit,** ***në specifikimin teknik të detyrueshëm.***

Tek Specifikacioni Teknik i Detyrueshme, në këtë specifikacion ceket qartë se preparatet të cilat përdoren për shërbimin e Dezinfektimit duhet të kenë A-testet si dhe lejen e

importit te produkteve te lëshuara nga Ministria e Ambientit Hapësinor (MMPHI). OE ***nuk posedon leje te importit (lejes së importit të produketeve biocide e lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor (MMPHI) të dt.22.04.2022 mungojnë preparatet biocide ofertën e tenderit nga OE fitues, përkatësisht kjo leje nr.226-2/22 është faqja e parë dhe e tretë, pra faqja e dytë "mungon"),*** **prezantimi i faqes së parë dhe të tretë të lejes së importit pa listë të preparateve që do të importohen (*faqja e dytë "mungon"*), *poashtu i mungojne A-testet*.**

Në vendimin me të cilën është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim AK, nuk e ka paraqitur në mënyrë të plotë pretendimet e ngritura në kërkesën për rishqyrtim, duke i ikur shërbimit të dezinsektimit, ku gjithashtu kërkohet leja e importit nga *Ministria e Ambientit Hapësinor (MMPHI*). *Jo profesionalizmi i Komisionit të Vlerësimit dhe njëanshëmria e tyre vërehet edhe në arsyetimin e pikës së lartcekur përkatësisht kjo leje nr.226-2/22 është faqja e parë dhe e tretë, pra faqja e dytë ("mungon"), kurse arsyetimi i saj është se dokumentet i kemi marrur nga zyra e Prokuorimit e çuditërisht kjo faqe e këtij vendimi që mungon nuk përfshihet në vendimin e AK-së*

Sa i përket Dezinsektimit gjithashtu kërkohet leja e importit te produkteve nga Ministria e Ambientit Hapësinor (MMPHI). OE nuk posedon leje te importit.

Sa i përket Deratizimit të gjithë rodenticidet duhet të jenë të shoqëruara me dokumentacion përkatës si listë të sigurisë teknike **(SDS), dhe certifikatë të analizave.** ***Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK.***

OE nuk posedon leje te importit për preparatet si dhe certifikatë të analizave e në rastin e Deratizimit është kërkuar edhe lista e sigurisë teknike e preparatave (Safety Data Sheets SDS) e cila mungon.

Sa i përket preparateve repelente per Gjarpinjë gjithashtu kërkohet lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK. OE nuk posedon leje te importit.

Shih vërejtjen.

Vërejtje: *Me rastin e ofertimit OE duhet të prezantoj edhe katalog/broshurë ose listë me të gjitha preparatet, të cilat Kompania posedon dhe i përdorë për kryerjen e shërbimeve të DDD-së, si dhe certifikatat përkatëse të preparateve. Të gjitha aktivitetet të zhvillohen*

konform standardeve të përcaktuara për shëndet dhe siguri në punë, duke shfrytëzuar preparate cilësore të destinuara për tregun e Evropës dhe të lejuara nga inspektorati Sanitar i Kosovës.

Shih te bashkangjitur lejen e importit ***(lejes së importit të produketeve biocide e lëshuar nga MBPZHR të dt.22.04.2022 mungojnë preparatet biocide ofertën e tenderit nga OE fitues, përkatësisht kjo leje nr.226-2/22 është faqja e parë dhe e tretë, pra faqja e dytë "mungon")***.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, provat e bashkëngjitura, dispozitat e shkelura ligjore, kërkesat e dosjes së tenderit konstatohet në mënyrë të pakontestueshme se OE Ankues ka të drejtë lidhur me pretendimet e ngritura, që të gjitha këto pretendime në një analizë të mirëfilltë të provave dhe bazës ligjore dëshmojnë shkeljet e bëra nga AK dhe domosdoshmerinë e anulimit të vendimit të AK.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

? Mosdhënia e kësaj kontrate kompanisë tonë rrezikon të na shkaktoj dëme materiale për vlerën e fitimit të munguar, përkatësisht vlerën e kontratës së shpërblyer.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*